

Data 20.12.2024

**PROCESVERBAL - Tipi i kontratës - E HAPUR E THJESHTUAR -
SHËRBIME**

PROKURIM ME MJETE ELEKTRONIKE

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

**OBJEKTI I PROKURIMIT: STUDIM-PROJEKTIM I OBJEKTIT SISTEMIM-
ASFALTIM RRUGA OROSH, BASHKIA MIRDITË**

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 71221000-3
Shërbim për projektim

VLERA E FONDIT LIMIT: 2'523'619.61 (dy milion e pesëqind e njëzet e tre mijë e gjashtëqind e nëntëmbëdhjetë pikë 61) Lekë pa Tvsh, i vënë ne dispozicion nga buxheti i Bashkisë Mirditë

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Mirditë, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

Procedura e prokurimit është e parashikuar në Regjistrin e planifikimit të Bashkisë Mirditë..

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”i ndryshuar.

Kriteret e mesiperme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertes”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në mbështetje të nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik: citojmë Neni 83 i LPP “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”, Neni 82, i LPP “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si prova paraprake në vend të disa vertetimeve të leshuara nga autoritetet publike ose pale të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1. Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Referuar pikës 1 të shtojcës 9 (Kriteret e Përgjithshme për Kualifikim), ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kriteret duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklarimit me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 9.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Vërtetimi për xhiron vjetore për vitet financiare (2021, 2022, 2023), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së parashikuar të kontratës. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Lloji i procedure është “Sherbim Konsulencë”, përcaktimi i vlerës së kërkuar është bërë në mbështetje të nenin 43, pika 2, germa “c” të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”i ndryshuar ku përcaktohet se: “40% të vlerës së parashikuar të kontratës në procedurat e

prokurimit..... dhe ne procedurat e prokurimit "Shërbim Konsulence" si dhe në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike", si dhe në Udhëzimin e Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar eshte bere ne mbeshtetje te nenin 43, pika 1 " të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" ku percaktohet se: " Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastiit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare".

2.2.2 Kopje të çertifikuara të bilanceve të tre viteve të fundit (2021, 2022, 2023) të paraqitur pranë autoriteteve përkatëse, të konfirmuara nga ky autoritet që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitet dhe pasivitet. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitet dhe pasivitet. Shënim: Akt Ekspertiza e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, duhet të paraqitet nga OE vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, gërma "c" të Ligjit nr.10091, datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar", i ndryshuar.

Shënim: Akt Ekspertiza e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, duhet të paraqitet nga O.E vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, gërma "c" të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar", i ndryshuar, ku parashikohet se: "Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, **për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm:** i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël".

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare". Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: "Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit

pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhëne tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrisë të Financave në zbatim të këtij ligji.

Ndërsa shoqërimi me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, është bërë duke iu referuar parashikimit në nenin 41 shkronja c” të Ligjit nr. 1009/2009: “Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikim të tyre, nga ekspertë kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë **dy prej tre treguesve të mëposhtëm: i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël**".

2.2.3 Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2023 si dhe këstin përkatës për vitin 2024 sipas përcaktimeve të Ligjit Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, (i ndryshuar). Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës sipas adresave të regjistruar sipas QKB. (Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetedeklarimit, dokumentet përkatëse vërtetuese do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar në nenin 77, pika 3, e LPP, nenin 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, si dhe ligjin nr.9920 date 19.05.2008 “Për procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 4, pika 2, gërma d) dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar. Ky kriter shërben për të garantuar AK se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi, kanë kapacitetet e duhura ekonomike dhe financiare si dhe janë të përshtatshëm për të kryer veprimtari profesionale. Referuar sa më sipër, Autoriteti Kontraktor gjykon se kriteri i vendosur lidhur me dorëzimin nga ana e operatorëve ekonomikë të deklaratës për shlyerjen e detyrimeve vendore për vitin 2023, pranë bashkisë/ve ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi e konkretisht me ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 për “Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për t’iu nënshtuar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.

Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Shënim: Operoret ekonomik të kualifikuar të fazës së parë (lista e shkurtër), duhet të dorëzojnë pranë AK, të gjithë dokumentacionin provues për vetedeklarimet të paraqitura në formularin

përmbledhës të vetëdeklarimit si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.

2.3 Për kapacitetin teknik

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate.

a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose faturat tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe në nenin 54 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën në një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar. Përvoja e ngjashme konsiderohet si kriter thelbësor dhe si rrjedhim operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi të tilla si referenca/fatura tatimore, për të provuar kryerjen e tyre qoftë me sektorin privat dhe atë publik.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohet, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi

2.3.2 Liçensa profesionale lidhur me shërbimet objekt i kontratës:

Liçensa profesionale të operatorit ekonomik (e vlefshme) për projektim (leshuar nga MZHUT ose nga Institucioni i Autorizuar sipas legjislacionit në fuqi për dhënien e licensave profesionale në fushën e studimit e projektimit në ndërtim, ku të përfshihen kategorite:

2. PROJEKTUES ARKITEKT

2-d) Projektim peisazhi, sistemim sipërfaqe te gjelberta, lulishte e parqe;

3. PROJEKTUES KONSTRUKTOR

3-c) Projektim: 2 troje dhe shpate me qendrueshmeri te ulet;

4. PROJEKTUES INSTALATOR

4-c) Projektim te linjave e rrjeteve elektrike, per objekte civile e industriale;

5. PROJEKTUES VEPRA HIDRAULIKE

5-b) Projektim furnizim me ujë – kolektorë shkarkimi.

6. PROJEKTUES RRUGË-HEKURUDHA

6-a) Projektim rrugë lokale, rruge urbane dytësore dhe rrugë interurbane dytësore.

7. PROJEKTIM URA DHE VEPRA ARTI

7-a) Ura dhe vepra arti të vogla deri më 10 m.

8. PROJEKTUES GJEODET

8-a) Rilevime inxhinierike

8-c) Sistemi GIS

8-e) Projektim fotogrametrik dhe hartografik

9. STUDIM GJEOLOGO INXHINIERIK - HIDROGJEOLOGJIK

9-d) Studim/vlerësim gjeologo-inxhinierik i trojeve të buta dhe shpateve me qëndrueshmëri të ulët.

11. PROJEKTUES TË SINJALIZIMIT RRUGOR

11-a) Projektim sinjalistike jondricuese në rrugë lokale, rrugë urbane dytësore, rrugë interurbane dytësore, sheshe e parkime.

12. STUDIME TË SIZMOLOGJISË INXHINIERIKE

12-b) Studime/vlerësime gjeologo-sizmike për trojet ku ndërtohen objektet civile, sociale e kulturore.

(Për Operatorët e huaj të bëhet njehsimi i licencës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës pranë institucionit përkatës, në plotësim të licencave profesionale të kërkuara për ekzekutimin e kontratës).

*Sqarim: Për licencat e lëshuara pas hyrjes në fuqi të Vendimit nr.943, datë 28.12.2016 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.759, datë 12.11.2014, të Këshillit të Ministrave ‘Për licencimin profesional të individëve dhe personave juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e projektimit në ndërtim dhe mbikqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë **Liçensa profesionale të shoqërisë (e vlefshme) për projektim (leshuar nga MZHUT** ose institucione të tjera të autorizuara sipas legjislacionit në fuqi për dhënien e liçensave profesionale në fushën e studim projektimit në ndërtim), e vlefshme, ku të përfshihen kategoritë e mësipërme me ndryshimet përkatëse në emërtesë.*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe vendimin nr.759, datë 12.11.2014 të Këshillit të Ministrave, “Për licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikqyrjes e koaludimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, ndryshuar me VKM-në nr.943 datë 28.12.2016” (shënim- përcaktoni aktin ligjor ose nënligjor specifik dhe nenin përkatës, që parashikon licencimin e subjekteve, në lidhje me veprimtarinë përkatëse për realizimin e shërbimeve objekt kontrate).

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente. Licencat e mesiperme janë vendosur në kuader të natyrës së përgjithshme të punimeve që priten të realizohen në këtë procedurë.

Për arsye të vështirësisë së objekteve të kontratës, rendesise strategjike të tyre, që lidhen jo vetëm me vendosjen e objekteve në zona zhvillimore me intesitet të lartë qarkullimi dhe zona studentore të rendesise strategjike për zhvillimin e sektoreve të arsimit të lartë, zona me infrastrukturë ekzistuese mbi dhe nëntokësore, si dhe kërkesave për cilësi sipas standarteve bashkëkohore, inovative të eficientes dhe energjise, vlerësojmë që operatorët ekonomikë duhet të zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm dhe të pranueshëm cilësie.

Më konkretisht, po paraqesim argumentimet si më poshtë:

<i>KATEGORI A E KERKUAR</i>	<i>PERSHKRIMI I KATEGORISE</i>	<i>ARGUMENTIMI</i>
2 - d	Projektim peisazhi, sistemim sipërfaqe të gjelbërta, lulishte e parqe;;	Bazuar në termat e referencës, parashikohet realizimi i rrugëve të cilat do të kenë peisazh turistik, si rrjedhojë gjykohet që kjo pikë është e nevojshme për realizimin me sukses të shërbimit të kërkuar. Gjithashtu kërkohen edhe rendera e video rendera.
3 - c	Projektim: 2 troje dhe shpate me qendrushmeri të ulët;	Bazuar në termat e referencës, parashikohet realizimi i rrugëve të cilat do të kenë edhe troje dhe shpate me qendrushmeri të ulët ose jo, si rrjedhojë gjykohet që kjo pikë është e nevojshme për realizimin me sukses të shërbimit të kërkuar.
4 - c	Projektim të linjave të rrjeteve elektrike, për objekte civile e industriale;	Bazuar në termat e referencës, parashikohet realizimi i rrugëve të cilat do të kenë kalime tërthore të rrjetit elektrik në trupin e saj, si rrjedhojë gjykohet që kjo pikë është e nevojshme për realizimin me sukses të shërbimit të kërkuar.

5 - b	Projektim furnizim me ujë – kolektorë shkarkimi.	Bazuar ne termat e referencës, parashikohet realizimi i rrugeve te cilat do te kene kalime terthore te rrjetit hidro ne trupin e saj, si rrjedhojë gjykohet qe kjo pike eshte e nevojshme per realizimin me sukses te sherbimit te kerkuar.
6 - a	Projektimi rruge lokale, rruge urbane dytesore dhe rruge interurbane kryesore	Bazuar ne termat e referencës parashikohet realizimi i rrugeve lokale dhe dytesore ne varesi te qarkullimit dhe trafikut qe do te percaktohet ne zhvillimin e projekteve te kesaj procedure, si rrjedhojë gjykohet qe kjo pike eshte e nevojshme per realizimin me sukses te sherbimit te kerkuar.
7 – a	Ura dhe vepra arti të vogla deri më 10 m.	Bazuar ne termat e referencës parashikohet realizimi i rrugeve lokale dhe dytesore si dhe realizimi i veprave te artit si mure mbajtes, mure prites, tombino, ura deri ne 10m, tombino box etj.
8 – a	Rilevime inxhinierike	Bazuar ne termat e references, kemi realizimin e projektit te rrugeve dhe rrjetit inxhinierik dhe si rrjedhoje gjykohet se eshte e nevojshme realizimi I rilevimeve inxhinierike per te gjithë infrastrukturen.
8 – c	Sistemi GIS	Bazuar ne termat e references, kemi realizimin e projektit te rrugeve dhe rrjetit inxhinierik dhe si rrjedhoje gjykohet se eshte e nevojshme realizimi edhe i sistemit GIS per te gjithë infrastrukturen.
8 – e	Projektim fotogrametrik dhe hartografik	Bazuar ne termat e references, kemi realizimin e projektit te rrugeve dhe rrjetit inxhinierik dhe si rrjedhoje gjykohet se eshte e nevojshme realizimi edhe i projektimit fotogrametrik dhe hartografik per te gjithë infrastrukturen.
9-d	Studim/vlerësim gjeologo-inxhinierik i trojeve të buta dhe shpateve me qëndrueshmëri të ulët.	Bazuar ne termat e referencës parashikohet realizimi i rrugeve si dhe realizimi i veprave te artit si mure mbajtes, mure prites, tombino, ura deri 10m, tombino box, kerkon studim gjeologo-inxhinierik te trojeve ku do te ndertohen keto vepra.
11 – a	Projektim sinjalistike jo ndricuese, ne rruge lokale, rruge urbane dytesore, rruge interurbane dytesore, sheshe dhe parkime.	Bazuar ne termat e references parashikohet rikonstruksioni i rrugeve, eshte e nevojshme parashikimi i realizimit te sinjalistikes jo ndricuese, tabela dhe vijezim horizontal, si rrjedhojë gjykohet qe kjo pike eshte e nevojshme per realizimin me sukses te sherbimit te kerkuar.
12 – b	Studime/vlerësime gjeologo-sizmike për trojet ku ndërtohen objektet civile, sociale e kulturore.	Bazuar ne termat e referencës parashikohet realizimi i rrugeve si dhe realizimi i veprave te artit si mure mbajtes, mure prites, tombino, ura deri 10m, tombino box, kerkon studim gjeologo-inxhinierik te trojeve ku do te ndertohen keto vepra.

2.3.3 Operatori Ekonomik duhet të ketë si drejtues teknik stafin si më poshtë dhe të jenë të përfshirë në listpagesën e shoqërisë për muajin e fundit të deklaruar;

- 1 (nje) Arkitekt;
- 2 (dy) Inxhinier Ndertimi, njeri prej të cileve me MSC për infrastrukture rrugore;
- 1 (nje) Inxhinier Hidroteknik;
- 2 (dy) Inxhinier Gjeodet;
- 1 (nje) Inxhinier Gjeolog;
- 1 (nje) Inxhinier Elektrik;
- 1 (nje) Inxhinier Mekanik;
- 1 (nje) Inxhinier Mjedisi i pajisur me certefikate për VNM;

Per stafin e percaktuar me sipër pika 2.3.3, Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:

Kontratave individuale të punës (të vlefshme), Licencat profesionale, Diplomë si dhe të figurojnë në listpagesa për muajin fundit të deklaruar.

Një projektues nuk duhet të jetë i angazhuar njëkohësisht në stafin e dy shoqërive që marrin pjesë në procedurën e prokurimit.

Shënim: Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës nr.9 “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatëve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”.

Në çdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose të kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Njesia e prokurimit për vendosjen e stafit i është referuar Termave të përgjithshme të referencës për objektet pjesë e kësaj procedure, pjesë e secilave do të jenë të licensuar për shërbimet që priten të realizohen.

2.3.4 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e shërbimeve objekt kontrate, duhet të disponojë stafin mbështetës (jo domosdoshmërisht drejtues teknik në licencën e shoqërisë):

- 1 (nje) Arkitekt;
- 1 (nje) Inxhinier Ndertimi profili strukturist,
- 1 (nje) Inxhinier Gjeolog;
- 1 (nje) punonjes te pajisur me certifikate leshuar nga Ministria e Mjedisit per Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis;

Per stafin e mesiperm Operatori Ekonomik duhet te paraqese:

Kontratat individuale te punes (të vlefshme), Licencat profesionale (kur jane kerkuar me siper), CV, Diplomë dhe cdo kualifikim tjetër qe verteton mbulimin e fushave te mesiperme.

Një punonjes nuk duhet të jetë i angazhuar njëkohësisht në stafin e dy shoqërive që marrin pjesë në procedurën e prokurimit.

Shënim: Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës nr 9. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”.

Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohej që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Njesia e prokurimit per vendosjen e stafit i eshte referuar Termave te references, natyres se pergjithshme te sherbimeve qe priten te ofrohen. Prezenca e stafit te mesiperm eshte gjykuar si e domosdoshme dhe e nevojshme per nje shperndarje dhe efikasitet sa me te madh ne realizimin e sherbimeve konkretisht;

- Punimet per sherbimin e projekteve kerkohen perpunime edhe arkitektonike, rendera dhe videorender, me shkalle te ndryshme veshtiresie te cilat kerkojne gjykim dhe punime te specializuara ne fushen e projektimit strukturor per te cilen kerkohet dhe staf ndihmes, si rrjedhoje gjykohet qe duhet te pakten **1 (nje) arkitekt** pjese e stafit ndihmes.
- Punimet per sherbimin e projekteve strukturore kane gjithashtu nje volum te rendesishem, pasi kryesisht parashikohet te kemi realizim te veprave te artit si mure mbajtes, mure prites, tombino, ura deri ne 10m, tombino box, me shkalle te ndryshme veshtiresie te cilat kerkojne gjykim dhe punime te specializuara ne fushen e projektimit strukturor per te cilen kerkohet dhe staf ndihmes, si rrjedhoje gjykohet qe duhet te pakten **1 (nje) inxhinier ndertimi profili strukturist** pjese e stafit ndihmes.

- Punimet per studimin dhe vleresimin gjeologjik do te jene te pranishme kryesisht ne ndertimin e veprave te artit, si rrjedhoje gjykohet si e nevojshme prezenca e te pakten **1 nje inxhinieri gjeolog si staf ndihmes.**
- **1 (një) punonjës të pajisur me certificate lëshuar nga Ministria e Mjedisit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis,** gjykohet si i domosdoshem pre realizimin e VNM (Vleresimet e ndikimit ne Mjedis) per projektet qe do te realizohen.

2.3.5 Operatori Ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij të paktën **15 (pesëmbëdhjetë) punonjës për muajin e fundit,** të vërtetuar me:

- a) Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për muajin e fundit te deklaruar.
- b) Listpagesat e punonjesve te konfirmuara nga autoritetet perkatese sipas formatit qe kerkohet nga legjislacioni ne fuqi per muajin e fundit te deklaruar.

Shënim: *Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës nr.9 “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”.*

Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën. Numri i përcaktuar i punonjësve është përllogaritur si më poshtë: per percaktimin e fuqise punëtore minimale te kerkuar argumentojme se jemi bazuar ne sherbimet e kerkuara sipas Termave te References. *Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë, tregon besueshmëri për autoritetin. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë çdo dëshmi me këtë kohështrirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve dhe përvojën e tyre, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Numri I mesiper perkon me stafin qe pritet te jete I angazhuar ne keto procedura.*

2.3.6 Operatori ekonomik ofertues duhet te paraqese nje deklarate ku te citohet lista e te gjithë stafit i cili do te jete i angazhuar ne kete kontrate.

2.3.7 Operatori ekonomik ofertues duhet te jete i pajisur dhe te paraqese Certifikatat te pershtatshme **ose ekuivalentet e tyre** per objektin e prokurimit si me poshte:

- a) ISO 9001: 2015, Per menaxhimin e cilesise (menaxhim i kualifikuar i sistemit te operimit dhe cilesise)
- b) ISO 14001: 2015, Per menaxhimin e cilesise se mjedisit;
- c) ISO 45001-2018 (e vlefshme). Sistemi i Menaxhimit për Shëndetin dhe Sigurinë në Punë;

Shënim: Në rastet e Bashkimit te Operatoreve ekonomik çdo anëtar i grupit duhet të paraqese certifikatën e mësipërme në bazë të zërave të marrë përsipër të realizoje sipas marrëveshjes së bashkëpunimit.

Argumentimi: *Kerkesat e mesiperme jane vendosur bazuar ne Nenin 79, pika 1 te Ligjit Nr. 162/2020, "Per prokurimin publik", sipas të cilit: "Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë", si dhe ne zbatim te Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", ku përcaktohet se: "Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit"*

Çertifikatat e cilesise jane bazuar ne perputhje jane ne perputhje me natyren dhe objektin e kontrates qe prokurohet.

2.3.8 Operatori ekonomik ofertues duhet te kete ne pronesi ose me qera pajisjet si vijon:

- 2 (dy) pajisje per matjet gjeodezike GPS
- 2 (dy) pajisje per matjet gjeodezike total station

Per plotesimin e kesaj kerkese duhet te paraqiten dokumenti qe verteton pronesine dhe skeda teknike e pajisjes (kurr merren me qera edhe kontrata e qerase).

Për plotësimin e kësaj kërkesë duhet të paraqitet një dokument i cili vërteton pronësinë ose aktin e marrjes me qera të tyre si dhe skeda teknike e këtyre pajisjeve.

Shënim: Sqarojmë se në përmbushjen e kriterit të sipërcituar, operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës nr.10 ku të deklarohet disponimi i mjeteve

Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Shënim: Operatorët ekonomik të kualifikuar të fazes së parë (lista e shkurtër), duhet të dorëzojnë pranë AK, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet të paraqitur në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Shënim: Operatorët ekonomik në përgatitjen e ofertes së tyre ekonomike/financiare duhet ti referohen VKM Nr.354, datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikimin të territorit, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim”, si dhe në mbështetje të Rekomandimit të Agjencisë së Prokurimit Publik datë 25.07.2017, me Nr. 5585 Prot “Mbi mënyren e përcaktimit të tarifave minimale të specifikuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.354, datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikimin e territorit, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim” si dhe Rekomandimit të datës: 27.06.2018 me Nr. 6559 prot te APP.

Vlera e paraprake e parashikuar e investimit 301’500’000 leke pa tvsh, grupi II tarifor.

Mospërgatitja e ofertës sipas bazës ligjore të sipërpërmendur përbën shkak për skualifikim pasi ajo duhet të jetë brenda kufijve të vlerës minimale dhe maksimale të lejuar në kuptim të nenit 7/1 të VKM Nr 354, datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikimin të territorit, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim”

Shënim: OE duhet të mbajnë në konsideratë përcaktimet ligjore, referuar Nenit 26, pika 1, të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku parashikohet se, “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, në lidhje me momentin e paraqitjes së dokumentacionit dëshmuës për kërkesat që përfshihen në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, ku parashikohet që, “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”.

- Mosparaqitja e dokumentacionit provues, do të jetë kusht s’kualifikimi.
- Autoriteti Kontraktor do të bëjë verifikimin e dokumentacionit në përputhje me vetëdeklarimin e bërë gjatë fazës së ofertimit. Konstatimi i mospërputhjeve midis

Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe dokumentacionit të dorëzuar përbën kusht s'kualifikimi.

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për shërbimet objekt prokurimi, që do të përfshihen në termat e referencës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.